



Pranuar / Dorezuar Punileno/Prodato Received/Delivered	03.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MSICK	3252/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.409/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.409/2022 të datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

i përfaqësuar nga Avokati me adresë:

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit numër: 565 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.04.2021, në çështjen juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.409/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Ref:565 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.04.2021,
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit të datës 07.05.2018 me numër:332.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kundër Vendimit me numër:565 të datës 07.04.2022 të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka parashtruar ankesë me datë 21.04.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimet ankimore se vendimi për transfer është nxjerrë mbi bazën e shkeljeve të ligjit material, shkeljeve procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe bazës juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 28.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse te Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 12.05.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 21.04.2022 me numër protokollit 2281/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Autorizimin e datës 13.04.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të ankuesit i datës 07.05.2018 me numër:332; vendimin për transferimin e ankuesit i datës 06.10.2021 me numër:724; Vendimin për transferimin e ankuesit të datës 07.04.2022 me numër:565; E-mailin e datës 20.04.2022 dërguar nga ankuesi për përfaqësuesin e tij ligjor; E-mailin e datës 19.04.2022 me kërkesën e bashkangjitur të ankuesit për qasje dhe sigurimin e dosjeve të lëndëve; E-mailin e datës 07.04.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; Kërkesën e datës 26.08.2021 dërguar nga ankuesi për Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; E-mailin e datës 25.08.2021 dërguar [redacted] dhe [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 17.04.2021 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 28.05.2022 dërguar nga ankuesi për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 24.05.2021 dërguar nga ankuesi për Balaj me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 17.05.2021 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 11.05.2021 dërguar nga ankuesi për F [redacted] i orës 6:36; E-mailin e datës 11.05.2021 dërguar nga ankuesi për [redacted] i orës 6:37; E-mailin e datës 11.05.2021 dërguar nga ankuesi për [redacted] i orës 6:36 me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 11.05.2021 dërguar nga ankuesi për [redacted] me e-mailin e bashkangjitur të datës 23.02.2021; E-mailin e datës 11.05.2021 dërguar nga ankuesi për F.T me e-mailin e bashkangjitur të datës 18.02.2021; E-mailin e datës 19.11.2020 dërguar nga ankuesi për R.S me e-mailin e bashkangjitur të datës 19.09.2022; E-mailin e datës 19.01.2021 dërguar nga ankuesi për L.V; E-mailin e datës 17.11.2020 dërguar nga ankuesi për I.S; E-mailin e datës 16.11.2020 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 15.11.2020 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 02.11.2020 dërguar nga ankuesi për Q.S; E-mailin e datës 31.01.2020 dërguar nga ankuesi për V.K; E-mailin e datës 31.01.2018 dërguar nga ankuesi për V.K; E-mailin e datës 31.05.2018 dërguar nga ankuesi për N.SH; E-mailin e datës 06.06.2018 dërguar nga ankuesi për N.SH; Vendimin e datës 25.11.2020 me numër:976/2020 ministrit të MPB-së; vendimin e datës 06.07.2020 me numër:731/2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 08.01.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Shkresën e datës 12.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 10.05.2022; ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 07.05.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave mbi bazën e shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshimit të Aktit të emërimit me numër:332 të datës 07.05.2018 është emëruar Udhëheqës i Divizionit për të Huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa përmes vendimit të datës 06.10.2021 me numër:724 Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së e ka transferuar përkohësisht-gjashtë (6) muaj, në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, ndërsa sipas pikës dy (2) të dispozitivit të të njëjtit vendim, ankuesit periudha e transferimit i përfundon me datë 06.04.2022, respektivisht i njëjt sipas pikës tre (3) pas mbarimi të periudhës së transferimit kthehet në pozitën që ka para transferimit, mirëpo institucioni punëdhënës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi të vetme se ankuesi është kthyer në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit të datës 07.05.2018, andaj Kolegji konstaton se ky veprim bie ndesh me nenin 52 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”* si dhe në kundërshtim edhe me nenin 4 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e ka pasur obligim ligjor ta kthejë ankuesin në vendin dhe detyrat e tij të punës të cilin e ka mbajtur përpara se të transferohet.

Po ashtu, Kolegji ka gjetur se Menaxheri i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ditën kur ankuesit i ka përfunduar periudha e transferim të përkohshëm sipas vendimit për transfer të datës 06.10.2021 dhe të kthehet në vendin e tij të punës, të njëjtin e ka transferuar serish përmes vendimit me numër ref:565 të datës 07.04.2022 për periudhë kohore prej tre (3) muaj me qëllim të përmirësimit të rezultateve në punë me arsyetimin se në Divizioni për të Huajt sa ka qenë udhëheqës është treguar nivel i dobët në menaxhimin dhe performancë e përgjithshme të njesisë me theksin e veçantë se në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion kanë mbetur 181 lëndë/kërkesa pa u proceduar qysh nga viti 2019 dhe po ashtu ankuesi gjatë vitit 2021 sipas formularit të vlerësimit të punës i datës 31.01.2022 është vlerësuar me notën 2.73 “mirë”.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së predikimeve ankimore të ankuesit sikurse dhe arsyetimit të ligjshmërisë së nxjerrjes së vendimit për transfer të datës 07.04.2022, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore për përmirësim të rezultateve në punë brenda institucionit dhe institucioneve të administratës shtetërore. 2. Transferimi bëhet me kërkesë të nëpunësit ose të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë e cila miratohet nga njësia përgjegjëse”* dhe ka ardhur në përfundimin se sipas shkresave të lëndës të dërguara nga Njësia e Burimeve Njerëzore nën dijeni të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, institucioni në fjalë nuk ka pasur plan vjetor për përmirësimin e rezultateve në punë brenda institucionit dhe po ashtu ka munguar edhe kërkesa e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit të cilën do të duhej më pastaj ta miratonte Njësia Përgjegjëse, madje sipas e-maili të datës 07.04.2022 udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit ia kishte konfirmuar të njëjtit se ai nuk ka bërë kërkesë për transferin e tij, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se në rastin konkret nuk janë plotësuar dy parakushtet mbi bazën e të cilave do të mund të llogaritej i rregullt transferi në fjalë, dhe në rastin konkret Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të rregullores dhe ligjit material.

Po ashtu Kolegji thekson faktin se sipas formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2019 i datës 08.01.2020 ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.03 e cila sipas Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil nenit 7 paragrafi 2 në paragrafi 2.4 e ka kuptimin e vlerësimit apo notës "Shumë mirë": "Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë" dhe në kuptim të nenit 7 paragrafit 3 nën paragrafit 3.3 të së njëjtës rregullore vlerësohet se: "Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim: "shumë mirë", vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon pritjet, kanë kontribuar në realizimin e objektivave të njësisë organizative", andaj mbi këtë bazë të vlerësimit të rezultateve në punë, Kolegji konstaton se ankuesi i ka përmbushur objektivat e punës për vitin 2019 madje ka kontribuar edhe në realizimin e objektivave të njësisë organizative, dhe po ashtu Kolegji thekson faktin se Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore duke pasur qasje në dosjen personale të ankuesit ka mundur lehtë ta verifikojë performancën e tij.

Referuar po ashtu formularit të rezultateve të punës për vitin 2021 të datës 31.01.2022 ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.73 e cila sipas nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullore nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcaktohet se: "nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë" e cila në kuptim të nenit 11 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 përcaktohet se: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", andaj Kolegji vlerëson faktin se sipas këtij formulari të ofruar në cilësi të provave nga institucioni punëdhënës ankuesi është vlerësuar me notën "mirë" nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë dhe sipas kuptimit të kësaj note i njëjti ka arritur t'i përmbush të gjitha objektivat.

Po ashtu, Kolegji i vë në vëmendje palët në këtë procedurë se viti 2020 ka qenë i përcjell me Pandeminë Globale Covid19 i cili shërben si fakt notor dhe sikurse edhe në vendet e tjera ashtu edhe në administratën shtetërore të Kosovës, shumë shërbime administrative janë pezulluar/reduktuar apo u ishte shtyrë afati për shkak të karantimit dhe reduktimeve të stafit, dhe po ashtu në këtë frymë Kolegji ka gjetur se në shkresat e lëndës ka gjetur se ekzistojnë dy (2) vendime të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 06.07.2020 me numër:731/2020 për shtyrjen dhe pezullimin e afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licencave, si dhe vendimi i datës 25.11.2020 me numër:976/2020 për zgjatje të afatit në procedurën e vendimmarrjes në Divizionin për të Huajt.

Kolegji thekson faktin se gjatë vitit 2019 deri me datë 09.07.2020 kur përmes aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese kishte hyre në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, kanë qenë të aplikuara dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përjashtuar periudhën kohore nga data 11.09.2019 deri me datë 20.11.2019, nga rrjedh se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk ka fuqi retroaktive dhe se asnjë nëpunës civil nuk mund t'iu nënshtrohet dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për periudhën kohore sa ka qenë në fuqi Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përjashtimisht dispozitave kalimtare të përcaktuara si në nenin 83 të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe se për performancën apo mos performancën e një nëpunësi civil për vitin 2019 nuk mund t'i bëhet transferim në vitin 2022 me qëllim të ngritjes apo përmirësimit të rezultatit në punë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe peshimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si pas pasqyrimit të gjetjeve si në arsyetimin e këtij vendimi,

konstaton se Vendimi me numër Ref: 565 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.04.2021 përmes të cilit ankuesi është transferuar me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës është nxjerrë në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë pasi që nuk ishte përmbushur asnjëri nga parakushtet e përcaktuara dhe po ashtu vendimi në fjalë në kuptim të nenin 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"* pasi që i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe diskrecioni i përdoruar apo e drejta e ushtruar për të transferuar stafin civil respektivisht ankuesin brenda institucionit nga Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore është përcjelle me shkelje procedurale të përcaktuar me aktin në ligjor i cili është derivat i paragrafit 7 të nenit 52 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se arsyetimi i dhënë në vendimin për transfer të datës 07.04.2022 nga Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i pamjaftueshëm apo i barabartë me mungesën e tij ngase palës në rastin konkret ankuesit nuk i është bërë e qartë përdorimi i bazës ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret sikurse ushtrimi i diskrecionit nga ana e Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim, referuar faktit se ankuesi përmes e-mailit të datës 19.04.2022 kishte kërkuar nga Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që të ofrojë dëshmi dhe fakte se për cilat lëndë në mënyrë taksative bëhet fjalë dhe se mbi çfarë baze është bërë konstatimi se ankuesi është përgjegjës për mos realizim e tyre gjatë vitit 2019 mirëpo i njëjti sipas shkresave të lëndës dëshmohej se ka heshtur ndaj kërkesës së ankuesit, andaj në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërlidhës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, konstaton se vendimi me numër:565 të datës 07.04.2022 përmes të cilit ankuesi është transferuar, në kuptim edhe të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është vendim i paligjshëm dhe si tillë shfuqizohet siç është përcaktuar edhe në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimin, Kolegji konstaton arsyetimi i dhënë me rastin e transferimit të ankuesit përmes vendimit me numër:565 të datës 07.04.2022 cenon parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publik të përcaktuar si në nenin 7 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.409/2022

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së

